



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:069172

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05843869

CT.nr.16/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në procedurën jokontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë, pas vdekjes së trashëgimlënëses H (Z) R ish nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, duke vendosur lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës për shqyrtimin e trashëgimisë, më datën 21.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

Pas të ndjerës H (Z) R ish nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me numër personal ..., e cila ka lindur më data..., ndërsa ka vdekur më data..., pa lënë testament e as kontratë mbi mbajtjen e përjetshme, shtetase e Republikës së Kosovës, SHPALLET për trashëgimtar, në bazë të trashëgimisë e me obligim të kthimit të borxheve eventuale të trashëgimlënëses, deri në lartësinë e vlerës së trashëguar:

- I. M (O) R, nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me numër personal, përndryshe nipi i të ndjerës, shpallet pronar në këtë masë trashëgimore respektivisht në pjesët si në vazhdim: 1/5 pjesë të parcelës me nr. 00115-1 ZK Krushë e Madhe, 1/5 pjesë të parcelës me nr. 00293-1 ZK Krushë e Madhe, 1/5 pjesë të parcelës me nr. 00620-1 ZK Krushë e Madhe, 1/5 pjesë të parcelës me nr. 00622-1 ZK Krushë e Madhe, 1/5 pjesë të parcelës me nr. 00623-1 ZK Krushë e Madhe, 1/5 pjesë të parcelës me nr. 00833-1 ZK Krushë e Madhe, 1/5 pjesë të parcelës me nr. 00983-3 ZK Krushë e Madhe, 1/5 pjesë të parcelës me nr. 00999-2 ZK Krushë e Madhe, 1/5 pjesë të parcelës me nr. 01715-1 ZK Krushë e Madhe.
- II. Detyrohet trashëgimtari i shpallur M (O) R që kësaj gjykate në t'ia paguajë taksën gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë, në shumën prej 100.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate është iniciuar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënëses H (Z) R ish nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, pasuria e së cilës është përshkruar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata gjatë procedurës dhe nga shkresat e lëndës ka vërtetuar se e ndjera ka pasur banimin e fundit në territorin e kompetencës territoriale të kësaj gjykate, se ka vdekur më 06.06.1994, pa lënë testament e as kontratë mbi mbajtjen e përvetshme, dhe se prej trashëgimtarëve të rendit të parë të trashëgimisë ka lënë trashëgimtarët dhe atë të birin O.R, e reja M R, mbesat M1.R- H, E.R-K, S.R, B.B dhe nipi i të ndjerës M.R.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje të trashëgimisë, më datë 14.06.2024, ku trashëgimtari M.R, ka pranuar që të shpallet trashëgimtarë në pasurinë e të ndjerës në pjesët që i takon sipas ligjit dhe në pjesët që eventualisht dikush prej trashëgimtarëve heq dorë të interes tyre, ndërsa trashëgimtarëve të tjerë nuk ua kanë mohuar të drejtën për trashëgimi, ndërsa mbesat e trashëgimlënësës M.R-H, E.R-K, S.R, B.B, kanë pranuar që të shpallen trashëgimtarë në pasurinë e të ndjerës, mirëpo nga kjo e drejtë kanë hequr dorë në favor të vëllait të tyre M.R.

Gjykata nuk e ka marrë deklaratën e propozueses M1.R pasi që e njëjta trashëgimlënësen H (Z) R ish nga fshati Krushë e Madhe, e ka pasur vjehërr, andaj në kuptim të dispozitave të Ligji për Trashëgiminë i Kosovës. Neni 13.1. *“Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij, e kur edhe të paslindurit për shkaqet e parapara me Ligj nuk mund të jenë trashëgimtarë, hyjnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim”*.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e neneve 12, 13.1, 119 dhe 135 të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës, si dhe në dispozitat e neneve 125, 128 dhe 162.1 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CT.nr.16/2023, më datë 21.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.